VENDIM
Nr. 42, datë 24.1.2018

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT NGA KATEGORIA "TOKË BUJQËSORE" NË "TOKË URBANE", TRUALL, TË PASURIVE ME NUMRAT 29/6, 29/7, 29/8, 29/9, 29/10, 29/11, 29/12, 29/13, 29/14, 29/15, 29/16, 29/17, 29/18, 29/19 DHE 35/32, ZONA KADASTRALE 3365, FSHATI SHETAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM,
BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "a", të pikës 3, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurive me numrat 29/6, 29/7, 29/8, 29/9, 29/10, 29/11, 29/12, 29/13, 29/14, 29/15, 29/16, 29/17, 29/18, 29/19 dhe 35/32, me sipërfaqe totale prej 50 300 (pesëdhjetë mijë e treqind) m^2, zona kadastrale 3365, fshati Shetaj, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, sipas certifikatave të pasurisë dhe hartave treguese, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, Qarku Durrës, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimin nga "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurive me numrat 29/6, 29/7, 29/8, 29/9, 29/10, 29/11, 29/12, 29/13, 29/14, 29/15, 29/16, 29/17, 29/18, 29/19 dhe 35/32, me sipërfaqe totale prej 50 300 (pesëdhjetë mijë e treqind) m^2, zona kadastrale 3365, fshati Shetaj, njësia administrative Ishëm, Bashkia Durrës.

3. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës të bëjë ndryshimin e llojit të pasurive në certifikatat e pasurive, sipas të dhënave për pasurinë e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Durrës dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi